



REPUBLIKA E KOSOVËS/REPUBLIKA KOSOVA

GJYKATA THEMELORE PRIZREN

---

Numri i lëndës: 2024:002757

Datë: 18.09.2024

Numri i dokumentit: 06176707

**C.nr.59/2024**

**GJYKATA THEMELORE NË PRIZREN-Departamenti i Përgjithshëm-Divizioni Civil**, me gjyqtarin Gëzim Shehu, në çështjen juridike kontestimore të paditëses D.B. nga Prizreni, të cilën me autorizim e përfaqëson av. B.M. nga Prizreni, kundër të paditurës (SHSKUK)-Spitali Rajonal "Prim. Dr. Daut Mustafa nga Prizreni, me objekt të kontestit kompensimi e pagës së 13-të, vlera e kontestit 942.00 euro, jashtë shqyrtimit gjyqësor, më datë 18.09.2024, mori këtë:

## A K T G J Y K I M

**I. REFUZOHET** në tërësi kërkesëpadija e paditëses D.B. nga Prizreni, me të cilën ka kërkuar që të **"DETYROHET** e paditura Sh.S.K.U.K.-Spitali Rajonal në Prizren, që paditëses në emër të kompensimit të pagës së 13-të për vitet 2018,2019 dhe 2020, të i paguajë shumën në lartësi prej 942 ( 314 x 3 ) euro, me kamat ligjore prej 8% nga dita e paraqitjes së padisë e deri në pagesën përfundimtare, si dhe shpenzimet e procedurës, të gjitha këto në afat prej 7 (shtatë) ditësh nga plotfuqishmëria e këtij aktgjykimi nën kërcënimin e përmbarimit të dhunshëm", **si e pa bazuar.**

**II.** Secila palë i bartë shpenzimet e veta procedurale.

## A r s y e t i m

Paditësja, D.B. nga Prizreni, përmes të autorizuarit të saj av. B.M. nga Prizreni, pranë kësaj gjykate me datë 04.01.2024, ka parashtruar padi, kundër të paditurës Sh.S.K.U.K.-Spitali Rajonal "Prim. Dr. Daut Mustafa", për çështjen juridike me objekt kontesti padi për kompensimin e pagës së 13-të, vlera e kontestit 942.00 euro.

Në referatin e padisë i autorizuari i paditëses ka theksuar se paditësja sipas kontratës së punës me kohë të pacaktuar nr.226, është në marrëdhënie pune, si hekurosëse në repartin e Shërbimet e Lavatores pranë të paditurës në Spitalin Rajonal të Prizrenit. E

paditura Sh.S.K.U.K. -Spitali Rajonal "Prim. Dr. Daut Mustafa", ku edhe vazhdon të punojë. Duke marrë për bazë dispozitat e Kontratës Kolektive Sektoriale nenit 17 par.2, paditësja disa herë verbalisht ka kërkuar nga e paditura si punëdhënëse që t'ia paguajë pagën e 13-të për punën e bërë në vitet 2018, 2019 dhe 2020, e paditura nuk i është përgjigjur në kërkesën e paditësit si dhe nuk e ka kryer obligimin e saj. Në vazhdim ka theksuar se kërkesa e paditëses është parashtruar konform dispozitave të Kontratës Kolektive Sektoriale nenit 17 par.2, për pagesën e pagës së 13 në vlerë të pagës bazë prej 314 euro, për vitet 2018 , 2019 dhe 2020. Në fund ka theksuar se paditësja ka përcjellur raportin e auditimit për pasqyrat financiare vjetore të Shërbimit Spitalor dhe Klinik Universitar të Kosovës për vitin 2020 dhe ka vërejtur se tek e paditura kanë mbetur në suficit mjete të lira shuma në vlerë prej 6,043,556.95 euro, nga të cilat mjete e paditura ka mundur të paguajë pagat e 13 për punëtorët shëndetësor. Andaj ka kërkuar që të aprovohet kërkesëpadia e paditësit si e bazuar.

E paditura në përgjigje në padi i ka kundërshtuar në tërësi të gjitha pretendimet e palës paditëse në padi. Ka theksuar se paditësja D.B. ka filluar marrëdhënien e punës në SPZ 09.03.1988, ku edhe vazhdon të punojë, ku pas refuzimit të kërkesës për kompensimin e pagave të trembëdhjeta (13), i është drejtuar gjykatës për realizimin e kërkesës së tij. Kërkesëpadia e paditësit është e pa bazuar nga arsyet se paditësja kërkesën e bazon në Kontratën Kolektive Sektoriale neni 17 pika 2, e cila marrëveshje në mënyrë parimore ka rregulluar shumë çështje nga marrëdhënia e punës. Në fund thekson se e kundërshtojnë kompensimin e pagave të 13-ta trembëdhjeta sepse nuk kanë mundësi buxhetore për plotësimin e kërkesës, sepse siç ceket paraprakisht sipas mundësive buxhetore të punëdhënësit, e paditura nuk ka mjete për t'i realizuar këto paga, për shkak të mjeteve të kufizuara buxhetore, për këto arsye kërkon nga gjykata që kërkesëpadinë e paditësit lidhur me kompensimin e pagave të trembëdhjeta (13) ta vlerësoj si të pa bazuar. Po ashtu ka theksuar se e njoftojnë Gjykatën Themelore në Prizren se kërkesëpadia është bazuar në Kontratën Kolektive Sektoriale të cilës i ka përfunduar afati kohor me datën 12.06.2021, që do të thotë kjo kërkesëpadi është jashtë Marrëveshjes Kolektive Sektoriale. Në fund ka theksuar se sa i përket pagës së 13 e kundërshtojnë, duke u bazuar në Ligjin e Punës nr. 03/L-212, neni 87 ku thuhet se të gjitha kërkesat nga marrëdhënia e punës në para, parashkruhen brenda afatit prej tre (3) vitesh. Shpenzimet e procedurës nuk i ka kërkuar.

Gjykata, pas shqyrtimit të padisë, provave që gjenden në shkresat e lëndës si dhe përgjigjes në padi të paraqitur nga e paditura, ka gjetur se janë plotësuar kushtet ligjore për marrjen e aktgjykimit jashtë seancës, të përcaktuara në nenin 399 të LPK-së, kjo sepse nga faktet e treguara në padi, dhe prapësimet e ngritura nga e paditura në përgjigjen në padi rezulton qartazi se kërkesëpadia e paditësit është e **pa bazuar**.

Mes palëve nuk rezulton të jetë kontestues fakti se paditësja është në marrëdhënie pune tek e paditura, në Spitalin Rajonal "Prim. Dr. Daut Mustafa" në Prizren. Kontestuese në mes palëve ndërgjyqëse është nëse paditësit i takon e drejta për kompensimin e pagave të (13) trembëdhjeta.

Në bazë të kontratës së punës me numër 226 me titull të postit H-55, gjykata ka vërtetuar faktin se paditësja ka të themeluar marrëdhënien e punës me punëdhënësin Spitalin Rajonal "Prim.Dr.Daut Mustafa" në Prizren, në vendin punës punëtor.

Në bazë të listës së pagave, gjykata ka vërtetuar faktin se paditësja realizon pagën bazë në shumën prej 314.00 euro.

Nga leximi i Raportit të auditimit për vitin 2020, gjykata ka vërtetuar faktin se buxheti fillestar për paga dhe mëditje ka qenë 57,190,921.00 euro, buxheti final për paga dhe mëditje ka qenë 76,308,249 shpenzimet për vitin 2020 kanë qenë 76,249,758.58 euro

Në bazë të njoftimit me numër të protokollit 3823 të datës 21.12.2023, gjykata ka vërtetuar faktin se Sh.S.K.U.K. për vitin 2018 ka pasur buxhet në shumën prej 55,938,388.67 euro ndërsa shpenzime në paga në shumën prej 58,242,229.27 euro, për vitin 2019 ka pasur buxhet në shumën prej 57,945,237.00 euro ndërsa shpenzime në paga në shumën prej 62,737,000.00, për vitin 2020 ka pasur buxhet në shumën prej 57,191,921.00 euro ndërsa shpenzime në paga në shumën prej 76,250,921.00 euro, për vitin 2021 ka pasur buxhet në shumën prej 56,076,877.00 euro ndërsa shpenzime në paga në shumën prej 73,825,422.00 euro dhe në vitin 2022 ka pasur buxhet në shumën prej 62,757,261.00 euro ndërsa shpenzime në paga në shumën prej 70,231,105.00 euro.

Në bazë të vërtetimit me nr.amz.226, të datës 31.03.2022, gjykata ka vërtetuar faktin se paditësja D.B. është në marrëdhënie punë në Spitalin e Përgjithshëm "Prim. Dr. Daut Mustafa" në Prizren nga data 09.03.1988, ku ende vazhdon të punoj dhe ka gjithsej 34 vite, 0 muaj dhe 21 ditë përvojë pune e cila është llogaritur deri më 31.03.2022 , kurse paga e fundit bazë është 314,17 euro.

Gjykata gjen se në rastin në fjalë duhet të zbatohen dispozitat ligjore të cekura në Kontratën Kolektive Sektoriale të Shëndetësisë në Kosovë të nënshkruar nga Qeveria e Kosovës dhe Federata e Sindikatave të Shëndetësisë së Kosovës e cila ka hyrë në fuqi me datën 12.06.2018, "Dispozitat e së cilës aplikohen në tërë territorin e Kosovës", ndërsa në nenin 4 paragrafi 1, është paraparë se "dispozitat e kësaj kontrate janë të zbatueshme për të gjithë punësuarit nëpër institucione shëndetësore. Po ashtu me Ligjin e Punës Nr. 03/L-212, me nenin 87 është përcaktuar " Të gjitha kërkesat nga marrëdhënia e punës në para, parashkruhen brenda afatit prej tri (3) vitesh, nga dita e paraqitjes së kërkesës". Përfundimisht me nenin 7.1 të Ligjit për Procedurën Kontestimore (LPK), është e

paraparë se *“Palët kanë për detyrë të paraqesin të gjitha faktet mbi të cilat i mbështesin kërkesat e veta dhe të propozojnë prova me të cilat konstatohen faktet e tilla”*.

Gjykata e ka refuzuar kërkesëpadinë e paditëses për kompensimin e pagave të 13-ta trembëdhjeta për vitet 2018, 2019 dhe 2020, pasi që sipas Kontratës Kolektive Sektoriale të Shëndetësisë në nenin 17 par. 2 parashihet *“Punëmarrësi mund të kompensohet me pagën e (13) trembëdhjetë për çdo vit kalendarik, në vlerën e pagës bazë, sipas mundësive buxhetore të punëdhënësit”*. Sipas vlerësimit të gjykatës dispozitat e lartcekura të kontratës kolektive sektoriale lidhur me pagesën e pagës së 13-të, nuk janë norma të karakterit detyrues, andaj është plotësisht në vullnetin e punëdhënësit që duke vlerësuar mundësit buxhetore, të iu kompensohet paga e 13-të punëtorit. Në rastin konkret, gjykata vendosi që ta refuzojë kërkesën për kompensimin e pagës së 13-të, pasi që pretendimet e të paditurës në lidhje me mungesën e mundësive buxhetore për kompensimin e tillë, gjykata i morri si të bazuara pasi që e njëjta gjykatës i ka dorëzuar si provë njoftimin me numër të protokollit 3823, të datës 21.12.2023 me të cilën janë vërtetuar mundësit buxhetore të saj, ndërsa paditësi nuk ka prezantuar prova materiale për të vërtetuar mundësitë buxhetore të të paditurës, por gjykatës i ka dorëzuar vetëm raportin e auditimit për vitin 2020. Andaj, meqenëse këtu e paditura nuk ka planifikim buxhetor të veçantë, që punëtorëve të iu kompensohen pagat e 13-ta dhe ka mjete të kufizuara buxhetore, gjykata vlerësoi se në këtë drejtim nuk mund ta detyroj të paditurën për kompensimin e pagave të trembëdhjeta për paditësin. Në këtë drejtim gjykata duke u bazuar në Mendimin Juridik të Gjykatës Supreme të Kosovës Për Zbatimin e Kontratës Kolektive Sektoriale Lidhur me Kërkesat e Pagës së 13-të të Punëtorëve Shëndetësor me numër 212/2023 të datës 09.10.2023, erdhi në përfundim se në mungesë të provave kërkesëpadija e paditësit është e pabazuar dhe si e tillë gjykata e ka refuzuar sikurse në dispozitivin nën I të këtij aktgjykimi.

Po ashtu, gjykata e vlerësoi të bazuar edhe pretendimin e palës së paditur lidhur me parashkrimin e kërkesës së palës paditëse. Kështu, sipas nenit 87 të Ligjit të Punës shprehimisht theksohet që *“të gjitha kërkesat nga marrëdhënia e punës në para, parashkruhen brenda afatit prej tri (3) vitesh, nga dita e paraqitjes së kërkesës”*. Nga shkresat e lëndës, më konkretisht nga data 30.12.2023, kur pala paditëse e ka parashtruar padinë gjykata vërtetoi faktin se e njëjta ka rënë në vonesë për të kërkuar mbrojtje gjyqësore për realizimin e kërkesës së saj, andaj nga të lartcekurat gjykata erdhi në përfundim se paditëses nga viti 2020, kur kërkesa e tij është bërë e arritshme e ka lëshuar afatin prej tre (3) vitesh për të kërkuar realizimin e të drejtës në kompensimin e pagës së trembëdhjetë.

Vendimi mbi shpenzimet procedurale, gjykata e mori në bazë të nenit 450 të LPK-së, pasi që pala e paditur nuk i ka kërkuar ato.

Numri i lëndës: 2024:002757  
Datë: 18.09.2024  
Numri i dokumentit: 06176707

Nga të cekurat më lartë, gjykata vendosi si në dispozitiv të këtij aktgjykimi e në bazë të nenit 143 dhe 399 të LPK-së.

**GJYKATA THEMELORE NË PRIZREN**  
**Departamenti i Përgjithshëm**  
**C.nr.59/2024, me datë 18.09.2024**

**Gj y q t a r i**

---

**Gëzim Shehu**

**KËSHILLË JURIDIKE:** Kundër këtij aktgjykimi palët kanë të drejtë ankese në afat prej shtatë (7) ditëve nga dita e pranimi pranë Gjykatës së Apelit në Prishtinë, përmes kësaj Gjykate.